



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:009663

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05601234

PA1.nr.1653/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.R, M.A dhe N.B nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit A.R, av. F.R të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.464/18 të dt.07.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit A.R, av. F.R, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.465/23 të dt.05.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, P.nr.464/18 të dt.07.11.2023, të akuzuarin A.R e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (tridhjetë) euro, si dhe si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Ndaj të akuzuarve M.A dhe N.B është refuzuar akuza për shkak se

prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza. I dëmtuari D.B nga Ferizaj, në rrugën “: për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit A.R, av. F.R, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ndaj të akuzuarit A.R të shqiptohet dënim me kusht sipas dispozitave të KPRK-së.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1685/23 të datës 28.12.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari A.R dhe avokati i tij mbrojtës F.R i cili deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar si dhe propozimit në ankesë, i akuzuari A.R deklaroi se mbetet pranë ankesës së parashtruar nga mbrojtësi i tije duke propozuar që të njëjtit ti shqiptohet dënim me kusht pasi që i njëjti është i dënuar me 17 vjet burg për vepra tjera penale. Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantoi në seancë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit, A.R, av. F.R e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal , me pretendimet se besojnë se me ndryshimin apo shqiptimin e dënimit më të butë respektivisht një dënimi me kusht në bazë të nenit 48 të KPRK-së. për arsye se edhe në seancë kur i mbrojturi Alban ka pranuar fajësinë, i kemi propozuar gjykatës që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato posaçërisht lehtësuese në bazë të nenit 242 të KPRK-së ku i kemi propozuar gjykatës që të mbrojturit A.R ti shqiptohet dënim me kusht, me të cilin dënim do të arrihej edhe qëllimi i dënimit, risocializimi dhe ri integrimi në shoqëri, sepse në seancë dhe fjalën përfundimtare e kemi dhënë pëlqimin për dënim me kusht. Prandaj në rast të shqiptimit të një dënimi - burgimi efektiv do të ishte në dëm të të mbrojturit dhe në kundërshtim substancial të nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Kushtetutën e Kosovës, Kodin Penal të Kosovës. dhe politikat ndëshkimore ndaj të mbrojturit A.R. Tutje vazhdon me arsyetim tjetër po ashtu se vepra e cila i vihet në barrë ka ndodhur në vitin 2017, dhe kanë kaluar më tepër se 7 vite, në rastin konkret ka humbur edhe qëllimi i dënimit faktikisht dhe juridikisht. për këtë duke marr parasysh veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 të KPRK-së. sipas këtij kualifikimi ka humbur edhe rëndësia e dënimit. arsyetim tjetër se edhe njëra nga të dëmtuarit i cili ka marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor nuk ka kërkuar që të dënohet dhe as kërkesë pasurore juridike. Dhe rrethanat që kërkojmë për

ndryshimin e dënimit, nga dënimi me burgim në dënim me kusht, besojmë se: Pranimi i fajësisë në fazën paraprake, po ashtu premtimi se nuk do ta përsërit veprën penale apo vepra të ngjashme penale, po ashtu si rrethanë lehtësuese duhet të merret se i mbrojturi është i moshës së re, dhe gjendje të rënduar ekonomike në familje. Andaj në bazë të gjitha kushteve ekzistuese- rrethanave të elaburuara si më lart në këtë ankesë të cilën e bënë plotësisht të përshtatshme për aprovimin e saj, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me kusht.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësi të të akuzuarit, që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me kusht, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me kusht për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku, si rrethanë lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimin të sinqertë dhe real për veprën e kryer penale, kërkim faljen publike nga ana e të pandehurit, faktin se i dëmtuari A.B nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se nga kryerja e kësaj vepre penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, moshën e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale,, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti faktin se i pandehuri A.R është dënuar më parë për vepra të ngjashme penale dhe atë më atë me aktgjykime të plotëfuqishme me numër P.nr.1758/17 i datës 01.03.2023, P.nr.2977/17 i datës 25.02.2022 dhe P.nr.1384/19 i datës 15.07.2022, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale dhe peshën dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1653/23, më datë 22.03.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri

Numri i lëndës: 2018:009663
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601234